




Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



DATË/A	27.06.2025
REFERENC-Ë:	
PËR/ZA/TO:	Kryeshefat Ekzekutiv te KRU-ve
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hajrije Morina, Drejtoreshë e ARRU
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përcaktimet e tarifave 2026 - 2028 dhe pritshmëritë për investime



Të nderuar,

Monitorimi ynë i performancës financiare ka nxjerrë në pah se për shumë vite KRU-të kanë grumbulluar burime të konsiderueshme parash të mbajtura si depozita (para kesh). ARRU konsideron se këto burime tejkalojnë nivelin e nevojshëm për të mirëmbajtur nivel të shëndetshëm të kapitalit qarkullues/ punues. ARRU konsideron se mbajtja e parave në këto nivele nuk u shërben interesave të konsumatorëve dhe as vetë KRU-ve. Këto burime financiare duhet të përdoren shumë më mire, duke i investuar në përmirësimin e shërbimeve për konsumatorët. Jo vetëm që do të përfitojnë konsumatorët, por do të gjenerojë kthim dukshëm më të lartë në bazën rregullatore të aseteve për KRU-të.

Për procesin e përcaktimit të tarifave për periudhën 2026-2028 pritet që biznes planet rregullatore të përfshijnë projeksione më realiste të investimeve. Për më tepër, nëse investimet aktuale nuk janë përmbushur siç ishte planifikuar dhe miratuar nga ARRU, konsumatorët do të kompensohen përmes ndikimit në tarifa, përmes një mekanizmi të kthimit të investimeve, e që do të aplikohet në procesin e përcaktimit të tarifave për periudhën 2029-2031. Kjo do të përfshijë edhe interesin e ngarkuar me një normë ekuivalente të kthimit në BRRA, që ato investime pritej të gjeneronin, nëse do të ishin zbatuar. Megjithatë, KRU-ve u kërkohet të mbajnë një rezervë të arsyeshme parash për qëllime të kapitalit qarkullues, ARRU pret që KRU-të të përfshijnë në planet rregullatore të biznesit një nivel investimi që mbështetet në burimet e tyre të disponueshme për të përmirësuar shërbimet për konsumatorët dhe në të njëjtën kohë për të rritur vlerën e BRRA-së mbi të cilën fitohen kthimet. Nga kjo strategji do të përfitojnë konsumatorët dhe vetë KRU-të.

E juaja,

Hajrije Morina

Drejtor, ARRU